



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

Klinë, 23 qershor 2026

www.komuna-kline.org			
09.09.2026			
Njësia org. Unit Organ. Jast.		Siç krah Amount	Vlera Amount to chest
01-06-29544			26

PROCESVERBAL

Nga takimi I parë për vitin 2026 I kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj, me qytetarë.

Takimin e hapi kryetari Elezaj duke përshëndetë gjithë qytetarët e pranishëm, kryesuesin e kuvendit dhe nënkryetarin e Komunës. Kryetari foli për rrjedhat financiare për 6 mujorin e parë të vitit 2026. Ai në vazhdim të raportit të tij tha: " Më lejoni që të përshëndes për prezencën nënkryetarin e komunës, zotin Fadil Gashi, dhe kryesuesin e kuvendit, zotin Enver Berisha, drejtorët e drejtorive, ju të pranishëm, media, qytetarë të komunës së Klinës. Në pika të shkurtra do të prezantoj një raport financiar. Në vazhdim do të mund të I them edhe disa fjalë rreth vështirësive dhe pengesave që kemi pasur dhe kemi gjatë këtij viti.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Buxheti i aprovuar gjatë këtij viti realisht është një buxhet i cili që në fillim të vitit ka hasur në vështirësi për shkak të mos aprovimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, domethënë është një prej viteve të rralla që ne e kemi pasur buxhetin e aprovuar dhe të lëshuar në funksion tek në muajin prill. Dhe gjatë atyre tre muajve as nuk kemi mundur me filluar procedurat e prokurimit, po është shfrytëzuar vetëm 1/12 pjesë e çdo muaji, është liruar vetëm për shërbime të veçanta siç janë pagat, mëditjet, po edhe mallra e shërbime për realizimin e nevojave dhe kërkesave që kanë, që dalin nga dikasteret e ndryshme. Ne këtë aspekt, kategoritë ekonomike që janë pagat dhe mëditjet deri më tani pra, totali, buxheti i aprovuar ka qenë 9,567,100 euro. Ndërsa shpenzimi që ka ndodhur deri në këto momente është 4,695,586.58 euro. Mjetet e pashpenzuara pra, 4,871,513.42 euro apo në përqindje 49.08% e realizimit të buxhetit deri më tani.

Nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, buxheti i aprovuar ka qenë 4,406,208.42 euro, ndërsa shpenzimet deri më tani janë bërë në vlerë prej 2 milion e 756 mijë e 626.17 euro. Mjetet e pashpenzuara janë 1,649,582.25 euro apo shprehur në përqindje 62.56%.

Kategoria tjetër ekonomike mallra dhe shërbime, buxheti i aprovuar është 1,911,300 euro e 7 centë. Shpenzimet që kanë ndodhur janë 1 milion e 212 mijë e 988 euro dhe mjetet e pashpenzuara kanë mbetur vetëm 698 mijë e 311 euro apo në përqindje 63.46%.

Nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, buxheti i aprovuar ka qenë 929,699 euro. Shpenzimet që kanë ndodhur deri më tani është 688,791 euro, ndërsa mjetet e pashpenzuara kanë mbetur vetëm 240,908 euro. Domethënë, me vëmendje duhet me i përcjellë se domethënë vlera, janë

edhe gjashtë muaj e më shumë, kanë mbetur vetëm 240,000 euro pashpenzuar, domethënë të gjitha të tjerat nga 929,000, pra 74.09%. Më vonë do t'ju tregoj pse ka ndodhur kjo domethënë, se ajo është përmbarimi, një fenomen shumë i keq që do të na sjellë shumë shqetësime gjatë këtij viti.

Kategoria ekonomike shpenzime komunale që janë rrymë, mbeturina dhe ujë, vlera e aprovuar në fillim të vitit ka qenë 490,000. Deri më tani janë shpenzuar 300,148 euro, kanë mbetur pa shpenzuar edhe 189,851 euro apo në përqindje 61.25%. Në total pra, buxheti i aprovuar 17,304,308.75 euro. Të shpenzuara deri më tani 9,654,141 euro, të pashpenzuara 7,650,167 euro apo në përqindje 55.79%.

Pra, të gjitha këto shpenzime do t'i shoqëroj edhe me një element tjetër që është prokurimi pra, që kontratat që ne i pretendojmë. Domethënë, këtë vit është viti i rrallë që vetëm 612,000 prej 17 milionë euro që i kemi buxhet, 17,340,000, vetëm 612,760 euro kemi lidhë kontrata të reja. Sepse përmbarimi nuk na ka lejuar me ecur përpara dhe ne kemi vështirësi të mëdha e përmbarimi bëhet fjalë për kontratat kolektive që janë sindikatat e pavarura që kanë lidhje me ministri të caktuara, siç janë Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë. Dhe tani si pasojë e një elementi që qeveria e Republikës së Kosovës, se me ato kontrata do të thotë obligohet qeveria, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave që t'i mbështesin komunat në buxhetimin e këtyre elementeve që janë përfshirë në marrëveshjet kolektive të bëra më herët, në 2017-ën, 2020-ën Komunat nuk e kanë pasur për detyrim me i siguruar mjetet për këto kontrata kolektive sepse nuk kanë qenë as nënshkrues të këtyre kontratave kolektive. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se punëtorët e arsimit, punëtorët e administratës, punëtorët e shëndetësisë kanë kontrata me komuna, jo vetëm me komunën e Klinës, por me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, atëherë gjykata e ka paditur vetëm komunën dhe përmbaruesit na i marrin mjetet financiare direkt në buxhetin e komunave. Me gjithë kërkesën përmes asociacionit, përmes kryetarëve të komunave në drejtim të qeverisë, në shumë takime, pa sukses. Domethënë, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i mbulon, nuk i rimbursen këto. Unë personalisht kam qenë një prej tre kryetarëve në komisionin e grandëve, pjesë e komisionit të grandëve që e votojmë komisionin e buxhetit për komuna dhe ne kryetarët e komunave nuk e kemi votuar buxhetin në komisionin e grandëve. Mirëpo, ata i kanë katër anëtarë, domethënë na mbivotojnë edhe e kanë votuar, edhe ka ecur procedura siç është buxheti. Pra, pa i plotësuar këto mjete. Tash, e keqja e kësaj është që tek këto mjete, krejt këto mjete financiare po merren. Për shembull, diku plus-minus 40%, 30 deri në 40% sipas rasteve i merr avokati e përmbaruesi, vetëm 60% i merr mësimdhënësi, punëtori i shëndetësisë e të tjerë. Por, është e drejtë e tyre dhe personalisht nuk guxoj me hy në këtë të drejtë të tyre. Po ajo që unë po flas është, e padrejta po i bëhet komunës sepse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë pjesë e përmbarimeve, dikush më shumë dikush më pak. Ne kemi qenë komuna që më së miri kemi qenë diku në vitin 2020, 2022. Kemi ecur shumë përpara, kemi paguar shumë me miliona euro atëherë pa përmbarim, po që qeveria aktuale na ka ndaluar realizimin e mjeteve në thesar. Edhe pse ne kemi dërguar mjete, kemi pasur mjetet tona në thesar, po thesari nuk i ka ekzekutuar për shkak të politikave të qeverisë sepse i ka lënë komunat në baltë në njëfarë forme. Tani unë mund t'ju jap edhe një shifër për këtë vit, sa na janë marrë mjetet nga përmbaruesi. Pra, ju i patët vlerat rreth 4 milionë euro që kemi investime për investime kapitale, ndërsa deri sot janë marrë 2,027,734 euro. Përmbaruesi deri sot i ka marrë 2,025,000 euro. Sot na ka ardhur një kërkesë, domethënë është një vlerë rreth mbi 80,000 euro për përmbarim, që ky ku do me t'i marrë? Ku me i marrë, s'ka ku i merr më. Në paga e mëditje, që është kategoria e pagave dhe mëditjeve thotë, në çdo kod buxhetor mundet me na thonë ku do, ku doni me ia marrë paratë, po vetëm në paga e mëditje jo. E për mos me u bë kualifikim i opinionit që sivjet do ta kemi opinionin e kualifikuar të auditorit për shkak të që i marrin paratë nga përmbaruesi

në kode jo adekuate. Ata thonë që veç në paga e mëditje nuk marrin sepse pagat dhe mëditjet janë mjete financiare që sigurohen nga grandet e qeverisë së Republikës së Kosovës. Pra, cilat kategori na janë marrë më së shumti? Mallra dhe shërbime 299,012 euro, shpenzime komunale 22,546 euro, subvencione dhe transfere 365,976 euro, do të thotë prej 800,000 eurove gati gjysmën e kanë marrë subvencionet. Tash ne do të ballafaqohemi me probleme të tjera. Ndihmë qytetarit për ndihmat elementare, dikujt i digjet shtëpia, dikujt ia vërshon uji, për ndonjë sëmundje, domethënë ka familje që janë me sëmundje shumë edhe ne tash duhet me dalë para qytetarëve, para anëtarëve të kuvendit me thënë që s'kemi. Me thënë të drejtën nuk është e lehtë për mua personalisht, as për drejtorinë e financave që me thënë s'kemi ku me ia dhënë. Po që Qeveria e Republikës së Kosovës me qasjen e saj në raport me komunat e Republikës së Kosovës, po flas për vete po kjo është gjithkund njësoj, e ka bërë që ne me qenë në një stad jashtëzakonisht të vështirë financiarë, që unë këtë element po dua me e ndarë bashkë me juve. Dhe nga shpenzimet kapitale pra, janë marrë 1,340,199 euro. Pra, këto janë disa nga elementet. Tash unë po mundohem pak në pika të shkurtra me ju thënë se si po mendojmë me mbijetuar këtë vit, këtë gjashtëmujorin e ardhshëm që do të kemi shumë vështirësi. Deri në këto momente kemi mundur me marrë prej një kodi me bartë, me korrigjuar me bartë në një kod tjetër. Tash ka ardhur momenti që s'di as askund ku me i marrë se s'ke. Unë frikona, kam kërkuar prej drejtorisë së arsimit që me i filluar procedurat, me mund me i marrë pak dru, pak pelet, me pasur për nxënësit. Do të ketë vështirësi në çdo element furnizimi. Sigurisht që do t'i drejtohem qeverisë me kërkesë që me na rimbursoi për me funksionuar. Nuk e nuk e di saktë edhe sa do të jenë kërkesat e përmbaruesit. Edhe ky është një element tjetër sepse ata çdo ditë, domethënë në kontratën kolektive i është dhënë hapësirë inflacionit. S'është inflacioni problem i komunës. Unë nuk e di qysh një ministër i financave nuk e merr për obligim që e ka, edhe ligjor, edhe moral, në çdo në çdo aspekt, nuk merret me inflacionin. Ne na i marrin të gjithë kategoritë e punësuarve në komunën e Klinës përmes gjykatave, kuptohet, na i marrin mjetet për inflacion. Çfarë ka komuna të bëjë me këtë? Edhe nuk i del në mbështetje, domethënë nuk i ndihmohet asnjë qytetari. Vijnë kombajnerët, kërkojnë subvencionim, domethënë jemi në një situatë që po mundohem sot me shfrytëzuar edhe prezencën e mediave që me iu adresuar qytetarëve me këto vështirësi që jemi sepse dikush e keqkupton thotë komuna s'i ka 100 euro, 200 euro, 500 euro, 1000 euro me i dhënë në një rast sëmundje vërtet që do të kishte dashur me i dalë në ndihmë. Po ne kemi pasur problem edhe me lindje, vdekje që kemi një rregullore që i paguajmë. Sido që të jetë, mos të vajtojmë shumë se në fund të fundit jemi këtu për me gjetur rrugë, me dalë prej kësaj krize. Edhe tash ne jemi përfitues të një grandit të performancës që ka qenë në fillim njoftimi 1,200,000 euro për shkak se jemi komuna më transparente në Kosovë. Mirëpo, çuditërisht para dy jave më thonë i ke marrë vetëm 752,000 euro shpërblim. Edhe me ato 752,000 euro tash kemi bërë një planifikim, i kemi shpërndarë 10-11 projekte me mund disa projekte siç është furnizimi me ujë për fshatrat Potočan edhe Leskoc, Ranoc, domethënë i kemi ndarë sepse kemi pasur mundësi me i ndarë 50,000 euro me i marrë prej performancës. Edhe projekte të tjera për shembull, ndërtimi i kanalizimit që na ka mbetur diku në lagje këtu, në Dërsnik, në Dollc, qytetit të Klinës, Shtupel, Kërrnicë, domethënë është pjesa që ende nuk është finalizuar. Edhe në Gremnik e do elemente të tjera i kemi ndarë krejt nja 20,000 euro për me mund me e marrë buxhetin e vitit të ardhshëm sepse tani procedurat janë strikte. Nuk mundesh me filluar asnjë projekt nëse nuk i ke zotuar mjetet.

Vitin e ardhshëm i kemi për shembull rreth 18 milionë euro, krejt duhet me i zotuar sepse procedurat dhe rregullat janë të tjera. Pra, pak më herët ka mundur me filluar projektin edhe 10,000 euro ndoshta projektin 1 milion, po sot s'mundesh. Mirëpo, duke e njohur mirë ligjin bashkë me të gjithë dikasteret e komunës, bashkë me drejtorinë e financave, bashkë me zyrën ligjore e cila është në përcjellje të

rregullativës ligjore dhe të procedurave që lejohen, po mundohem me bë të pamundurën që me I iniciuar projektet, ato që janë vitale për qytetin e Klinës.

Sa I përket projekteve , asnjë projekt nuk është në procedurë të re, asnjë projekt nuk e kemi iniciuar këtë vit. Asnjë procedurë nuk kemi mundur të fillojmë shkaku I mungesës së buxhetit. Po shpresoj që gjatë këtij viti kemi me e kaluar pjesën kryesore të shqetësimeve që kemi me përmbaues. Ka shumë qytetarë që ju kam premtuar se do të vij që të shikoj projektin , ne do të dalim dhe do ta shohim projektin por mundësitë për realizimin e tij janë të vogla për këtë vit. Na duhet të orientohe mi tek projektet emergjente, që nuk presin.

Kryetari Elezaj foli për shpronësimin e pronave tek rruga e transiti, për rrugën që ka shumë shqetësime "Mal Bashota", për rrugën në hyrje të qytetit që është gërryer nga operatori dhe që siç tha kryetari ajo rrugë është në përgjegjësi të ministrisë së infrastrukturës edhe që Komunën nuk e kanë pyetur fare.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Unë pak e zgjata, por me qëllim që t'ju jap një informim sa më të detajuar. Nëse dikush prej juve dëshiron fjalën, me shpreh ndonjë shqetësim, jeni të mirëpritur. Tash nuk guxojmë ne me thënë se jemi keq e s'duam me pasur të ardhme, sepse të ardhmen e kemi përpara. Ne do ta zhvillojmë, do ta planifikojmë të ardhmen mbi bazën e perspektivës dhe potencialit që e kemi të programuar në dokumentet bazike edhe financiare, edhe të gjitha ato që na udhëheqin në rrugëtimin tonë. Pra, kërkesat gjithsesi mos i ndalni, sepse nëse s'mundemi t'i bëjmë në shtator, i nisim në tetor, i përfundojmë gjatë vitit të ardhshëm. Domethënë, unë po shpresoj që vitin e ardhshëm, të paktën nuk kemi me pasur shumë pengesa. Por pengesat janë që operatorët ekonomikë që po kryejnë punë sivjet, nuk mundemi t'i paguajmë sivjet dhe kanë me na u bartë vitin e ardhshëm. Domethënë, edhe viti i ardhshëm planifikohet me qenë një vit i vështirë. Një element po prek, elementin e furnizimit me ujë të pijes. Ne vitin e kaluar e kemi përfunduar fundërruesin për furnizim me ujë të pijes, i cili është funksional. Edhe funksionon dhe jep rreth 100 litra në sekondë ujë që merret – ujë direkt nga Drini. Edhe përmes procesit të planifikuar me teknologjinë e fundërruesit, po funksionon mirë. Nuk po funksionon ndërlidhja e fundërruesit me fabrikën e mëhershme, edhe pse Ministria e Ekonomisë, bashkë me kompaninë "Hidrodrini", i kanë ndërruar krejt filtrat e rinj. Prapë diçka nuk po funksionon. Por, tani aktualisht jemi duke diskutuar këtë çështje me shumë donatorë: me UNDP-në, me Universitetin e Këlnit, me disa donatorë të rëndësishëm. Dhe do të kemi mbështetje edhe nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për projektimin e një fabrike të re, me kapacitet 300 litra në sekondë, direkt nga Drini, e cila do të jetë fabrikë e kategorive, domethënë e ngjashme, në funksionimin e saj për përfitimin e ujit cilësor. Edhe normal, këto kemi menduar që kanë me hy shumë më shpejt në projekt, por po na duhen donatorë për shkak të vështirësive financiare. Edhe unë mendoj që vitin e ardhshëm diku do të duhej që ne me filluar me ndërtuar fabrikën e re dhe me menduar ndoshta për me zgjidh problemin, sepse edhe unë personalisht u bë viti i nëntë që jam në qeverisje dhe nganjëherë them me vete: asnjë moment nuk jam ndalur. Me të gjitha kapacitetet e mia, me të gjitha kapacitetet që ka komuna dhe të gjitha ato institucione që ndërlidhen me funksionimin tonë, nuk jam ndalur duke u angazhuar për me zgjidh problemin e ujit. Por, komuna e Klinës vetë nuk po mund ta zgjidhë. Domethënë, duhet bashkëpunim gjithsesi me nivelin qendror. Ne e kemi një raport të një komisioni ndërministror, pra që e ka themeluar Kryeministri Kurti, dhe po shkojmë me implementimin – drejt implementimit të rekomandimeve që kanë dalë, e që është faza e dytë. Pra, pas fundërruesit është ndërtimi i një fabrike me kapacitet rreth 300 litra në sekondë, e cila besoj, sa merr koha e investimit, ndoshta dy vite duhet me planifikuar. Por, banorët e fshatrave Radollovc, Jagodë, Grabanicë dhe të gjitha ato fshatra që ndërlidhen sigurisht që unë i takoj shpesh edhe jam me kërkesat e tyre. Por, furnizimi me ujë të pijes është kompetencë e

"Hidrodrinit". Normal që ne bashkëpunojmë. Unë javën e kaluar i kam takuar menaxhmentin e "Hidrodrinit" dhe i kam thënë: krejt çka kemi mundësi me bashkë financuar si komunë – jo shumë për këtë vit, por ju paguani obligimet këtë vit, ne i marrim vitin e ardhshëm në blerjen e disa pompave, në freskimin e kapaciteteve teknologjike të kompanisë "Hidrodrini" – jemi të gatshëm si komunë, me të gjitha potencialet financiare, me marrë pjesë në bashkëfinancimin e të gjitha projekteve që ata i shohin si të rëndësishme. E kjo është, edhe në vazhden e kësaj, edhe finalizimi i projektit të CDI-së që ndoshta që 10 vite, që 7-8 vite kështu, edhe nuk po finalizohet pjesa e Radollovcit, rezervuari i Radollovcit. Për shembull, që një vit flasim për një lidhje me e bërë diku në Çabiq, që janë këputur gypat dhe mbi teknologji të caktuar, tek javën e kaluar e kanë eliminuar. Kërkesa ime ka qenë që diku me 15 maj të paktën të lëshohet uji në rezervuarin e Radollovcit, se fshati Radollovc, Jagodë, Grabanicë, të gjitha ato fshatra që gravitojnë të kenë ujë. Premtimet janë që edhe 10 ditë, po në njëfarë forme nuk po rregullohet. Është kompetencë, është përgjegjësi direkt e kompanisë "Hidrodrini", se unë nuk mundem me shkuar aty me i thënë atij punëtorit të tyre "hajde", se as nuk kam me më dëgjuar. Pra, bordin e kompanisë publike "Hidrodrini" e emëron Ministria e Ekonomisë, që është në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Bordi i emëruar prej ministrisë e emëron drejtorin. Edhe ata funksionojnë mbi bazën e këtyre dy mekanizmave menaxhues. Pra, ky është elementi që ne nuk kemi asnjë ndikim menaxhues në këtë kompani. Çka kemi ne? Kërkesat që i bëjmë në emër të qytetarëve. Unë i falënderoj shumë që gjithmonë ata mundohen me na dalë në ndihmë, por që nuk janë në nivelin e përgjegjësive... kjo është shumë e vërtetë. Nuk po zgjas më shumë. Nëse dikush mendon me u kyç, vetëm prezantohuni për shkak të procesverbalit edhe lirshëm mundeni me debatuar. Faleminderit shumë!

z. Mark Gojani: Përshëndetje kryetar! Përshëndetje të gjithë të pranishmëve! Unë jam Mark Gojani, nga fshati Budisalc. Po shoh këtu, bashkësi lokale e Budisalc, investime vetëm deri në 2028-ën, ura mbi Drinin e Bardhë. Po shihet që s'ka tjetër? Tek bujqësia vetëm kanalizimet. A thua deri në 2028-ën s'ka?

z. Zenun Elezaj, Kryetar: Mark, po ne i kemi pasur dëgjimet buxhetore që e kemi diskutuar këtë çështje. Sot jemi pak më shumë për ecurinë e qeverisjes, po edhe në këtë drejtim, siç e din, gjithmonë ne kërkesat fillestare i marrim prej kryesisë që e udhëheq për fshatin Budisalc edhe fshatrat për rreth. Sipas informatave që kemi, rrugicat, kanalizimi është finalizuar. Domethënë bëhet fjalë për ndonjë rrugicë të vogël 50-60 metra, 10 metra, por që kemi një buxhet minimal domethënë, 40-50 mijë euro, që mundemi me i mbuluar këto kërkesa, edhe në kanalizim edhe në rrugica. Projekti i kanalizimit – investimet më të mëdha që janë bërë në kanale të ujitjes në komunën e Klinës janë në Budisalc, këtu domethënë nuk ka dilemë. Por që nuk mundemi tani me i kryer për një ditë, është e vërtetë. Edhe jemi duke kontaktuar pak me nivelin qendror që ata me na mbështet në një projekt pak më të madh për kanale të ujitjes, sepse tash këtë vit jemi koncentruar pak në Dollovë, Grabanicë, Jagodë e pjesë të tjera, por që mundësitë janë shumë të vogla. Me sa di unë, edhe nga 23 mijë euro i kemi me i shpenzuar. Faleminderit shumë!

z. Mark Zefi : Për ujë na keni premtuar prej mandatit të parë që e keni marrë. E tash ne jemi në mandatin e tretë. Fshati është duke vuajtur sot, me cisterna po bartin. E komuna na pat dhënë premtime të forta. Deri sot nuk i ke realizuar ato fare. Herën e fundit kur ke qenë, ke thënë "do të dalim në terren". Pse nuk jeni në gjendje me i dalë qytetarit përballë? Kam, kam, s'kam, s'kam. Pra, vetë ke premtuar në mandatin e parë kur ke ardhur, se uji në fshatin Radulloc s'ka me munguar. E sot e atë ditë nuk ka ujë? Unë personalisht kam thënë, sa për mua kurrë një metër gyp mos e qitni fare se kam ujë mjaft. Por janë disa fshatarë, po vuajnë sot, me sisteme të ndryshme po bartin ujë prej Drinit, mbushin rezervuarë, sa për ujë të pijes, plot nga Klina shkojnë marrin në Pejë, shkojnë marrin në Istog, edhe vetë

e marrë. E derisa nuk ua plotëson nevojat qytetarëve për ujë e për gjëra elementare, mua më duket kot. Asgjë nuk realizohet sipas planifikimit, çdo gjë është jashtë kontrollë sipas meje.

Z. Zenun Elezaj, Kryetar: Faleminderit, Mark! Në fshat ka sistem të ujësjellësit, Nuk kanë në lagjen Duhani, ndoshta janë 4-5 shtëpi lart që nuk kanë. E kemi diskutuar, unë e kam funksionalizuar sistemin e ujësjellësit për fshatin Krushevë e vogël, ka ardhë gypi deri te ju. Por tani nuk ka para, këtu i dhashë disa arsye. E thashë edhe atë që ju kam premtuar qytetarëve se do të dal, por derisa të kem zgjidhje financiare me i thënë që këtë ditë vijnë, nuk po mundem me ardhë. E potencova në fjalën time edhe atë që nuk kam mundur me u dalë qytetarëve në premtim kur ju kam thënë "do të vij pas dy jave, do të vij pas tre jave", sepse jemi në momentet kur po i bëjmë projeksionet, po aprovojmë kornizën afatmesme buxhetore. Edhe pastaj ndoshta mundemi me i thënë vitin e ardhshëm, se shpresë është edhe ajo, në fund të fundit me thënë të vërtetën. Sa i përket shtëpive, nuk ka shumë shtëpi aty pa ujë. Projektin ja kemi dorëzuar "Hidrodrinit" komplet. Pse ata nuk po mund ta funksionalizojnë, është tjetër arsye. Unë nuk kam në njëfarë forme mundësi me ndikuar direkt në menaxhimin e "Hidrodrinit". Janë organe të tjera që e menaxhojnë dhe janë kompetente për këtë çështje. Por, me të gjitha mundësitë, tash këtë vit i kemi ndarë 100 mijë euro për projektin për ujë. Janë dy opsione, ende nuk e kemi definuar, brenda dy jave duhet me definuar, afër Drinit, me i hapur dy-tre puse, me ndërtuar një rezervuar dhe me i lidhë edhe me e furnizuar, me ardhë uji. Ose "Hidrodrini" po propozon brenda jave ka me na dhënë zgjidhje teknike, me vazhduar gypin që është në Krushevë të vogël deri në Zllakuqan që do të na duhen 100 mijë euro. Është e vërtetë, në Potoqan s'ka ujësjellës. Por meqenëse është pozita e përshtatshme për shkak se është në nivel të Drinit, shumica e familjeve kanë mundësi me hapur ndonjë pus. Kanë ujë. Ndërsa disa që janë në pjesën e lartë, në lartësi mbidetare, për ato kemi menduar projektin që besoj brenda dy-tre jave firmoset me Ministrinë e Pushtetit Lokal. Edhe do të fillojmë të instalojmë gypin, prej rezervuarit të Tigveshit me u lidh me një kapacitet të vogël për një vit-dy, derisa të kompletohet tubacioni që është në transit. Edhe ai tubacion është i planifikuar me pasë sasi pak më të mëdha me furnizuar Gremnikun deri në Zllakuqan, edhe pjesën e fshatrave për rreth.

Zefi: ju përshëndes të gjithëve. Edhe unë jam aty, jetoj aty. Javën e kaluar i kam qelë, nga 45 metra, përfund asfaltit i kam qelë puset, s' më ka dalë pikë uji. Unë nuk e diji çfarë zgjedhje me bërë si familjar, tash duhet me kërkuar zgjedhje tjetër. Në bazë të terrenit, nuk kemi ujë ne aty. Ju kisha lutur të shihnim një zgjedhje me e bërë sa më shpejt, se vijnë tash mërgimtarët, e po ashtu rinia janë duke na ikur. Mos me i lënë të rinjtë me na ikur, se po thonë s'kemi ujë, s'kemi këtë, s'kemi atë, kjo mua më duket shumë keq, si familjar. Nuk jam i vetëm unë, por jemi shumë që s'kemi ujë, jemi shumë në hall.

Z. Zenun Elezaj, Kryetar: Faleminderit! Unë jam i vetëdijshtë, e di që ka probleme në atë pjesë, por e kemi idenë e këtë projekti. Tash zgjedhjet teknike duhet me na e dhënë "Hidrodrini", sepse nuk mund ta marrim përgjegjësinë teknike ne si institucion qeverisës. Edhe jemi në pritje sipër, janë ndarë me projekt trevjeçar 100 mijë euro, janë ndarë tani. Ideja është që me marrë një gyp prej diku te Feniksi, Krushevë ku ka mbetur, edhe me dërguar diku deri në Zllakuqan. Atëherë aty me bërë zgjidhje. Ne po kemi nganjëherë mungesa e interesimit për debate. Por, gjithsesi unë e kam dhënë fjalën që me thirrë Zefin edhe me dalë për një çështje tjetër të kanalizimit. Por për këto të ujit e kemi bërë zgjidhjen, po besoj që jemi futur në zgjidhje të problemit. Edhe që ai tubacion me u lidh me gypin kryesor, ideja është me u lidh diku te rezidenca, kështu më kanë thënë si propozim. Edhe për momentin me lëshuar kapacitete të vogla me kontroll, se nuk ka ujë shumë as në rezervuar.

z. Lekë Frroku: Përshëndetje të gjithëve! Përshëndetje pjesëmarrësit! Unë jam përfaqësues i fshatit Dollc, por jam edhe kryetar i bashkësisë lokale. Edhe unë i kam të njëjtat kërkesa dhe të njëjtat halle si të gjithë. Ndoshta po bëhemi edhe të tepërt, sepse kemi biseduar zoti kryetar edhe në javën e kaluar por është problemi që ne fshati e kemi ujësjellësin, por dikush ka ujë aty edhe me ujit lule, edhe me ujit kopshte. E kjo pjesa e lartë e familjes Frroku, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, edhe gjysmën e tetorit jemi pa pikë uji. Herë pas herë ka, por më shumë 90% jo. Ne kemi biseduar zoti kryetar edhe çdo herë që jemi takuar kemi pasur këtë problem. Por nuk e di se ku është faji. Shembulli i djeshëm: sa herë që bie shi, mbushen gypat me ujë aty ndërsa sot s'ka pikën. Unë nuk e di ku është problemi. Pse 20 minuta ka ujë kur bien shi dhe 24 orë të tjerë nuk ka. Problem tjetër është kanalizimi, aty s' ka kanalizim. Pastaj çështja e rrjetit elektrik. Po bëhen punime në rrugë, ka shtylla gati të rrëzuara. Ju lutem, jeni i zoti i shtëpisë kryetar, ndihmoni fshatin tonë dhe në Dollc është mundësia që të na ndihmoni sepse është rrjeti i ujësjellësit. Ju kërkoj falje për emocionet.

z. Zenun Elezaj, kryetar: E kemi diskutuar edhe gjatë dëgjimeve bugetore në Zajm. Si zgjidhje të problemit e shohim finalizimin e gypit kryesor përgjatë transitit. Me të drejtë pyet se pse dikush ka e dikush nuk ka, por ai që është në nivel më të ulët ka edhe me ujit pemë e kopshte, ndërsa të tjerët që janë lartë nuk aknë. Kjo ndodhë edhe në fshatin time edhe gjithandej. Në takim me drejtorin dhe menaxhmentin e "Hidrodrinit" ju kanë shprehë gatishmërinë time dhe të inspektoratit komunal që të kontrollojmë përdorimin e ujit gjithandej komunës, sepse është obligim që parësore të jetë uji i pijes, pastaj amvisëria dhe nëse kemi tepërcë të ujit pastaj për ujitje. Kapacitetet e ujit që i kemi janë të mjaftueshëm për amvisëri por duhet të përdoren me kujdes. Është mirë që inspektoratit të merret më këtë çështje. Po e kërkoj publikisht që edhe inspektorati i "Hidrodrinit" edhe komunal por edhe policia që të inspektojnë përdorimin e ujit.

Këtu përfundon takimi i kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj me qytetarë.

Procesmbajtës

Skënder Behramaj

Kryetari

Zenun Elezaj

